

D E K R E T
Nr.772, datë 14.2.1994

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7693, DATË 6.4.1993 “PËR URBANISTIKËN”

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J,

Neni 1

Në ligjin nr.7693, Datë 6.4.1993, Pas nenit 29 shtohet neni 29/a, me këtë përmbajtje:

“Rregullat e përcaktuara në nenin 29 të zbatohen edhe për të gjitha sheshet e ndërtimit të dhëna nga organet e pushtetit lokal që nga data 1.1.1990. Personave fizikë e juridikë që kanë kryer veprimet e blerjes e të regjistrimit në hipotekë e kadastër të këtyre shesheve, kur vendimet e miratimit të tyre bëhen të pavlefshme do t’u kthehet shuma e paguar për sheshin, e indeksuar me indeksin e çmimeve të konsumit.

Neni 2

Afatet e paraqitjes së kërkesave për leje ndërtimi për sheshet sipas nenit 1 fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të këtij dekreti.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha